VENDIM
Nr.685, datë 31.3.2008

PËR MOSDHËNIE LICENCE
PËR TELEVIZIONIN KABLLOR PRIVAT "TV KABLLOR DUSHK"

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores "Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë, radio e televizivë" dhe rregullores "Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll", Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të mos licencojë për transmetim televiziv privat kabllor subjektin "TV kabllor Dushk", pasi në dokumentacionin e paraqitur mungonte:

a) kapitali themeltar.

2. Subjekti mund të ankohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu "Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative".

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)